REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.** **Tiranë ___/___/2015**
Nr. Dok. 201500711/2

Lënda: *Rekomandojmë që nga ana juaj të merren masa për ekzekutimin e vendimit gjyqësor datë 10.03.2015 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Krujë, për të dënuarin F. Z., i dënuar në I.E.V.P. Krujë*.

Drejtuar : **Z. Artur ZOTO**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve
TIRANË

***I nderuar Z. Zotaj*,**

Ju vemë në dijeni se me Shkresën me Nr.144 prot, datë 30.04.2015 Komiteti Shqiptar i Helsinkit Tiranë, ka njoftuar institucionin e Avokatit të Popullit për të dënuarin F. Z. i cili ndodhet duke vuajtur dënimin me burgim në I.E.V.P. Krujë, me faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me vendimin e saj datë 10.03.2015 ka vendosur si vijon :

Pranimin e kërkesës.

Garantimin e shërbimit të përshtatshëm mjeksor nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë, dhe nga Drejtoria e I.E.V.P. Krujë dhe ndërprerjen e trajtimit ç'njerëzor e degradues si rezultat i mungesës së këtij trajtimi.

Nga studimi me kujdes i këtij njoftimi dhe i materialeve përkatëse rezultoi se : I dënuari F. Z. ka lindur banon në qytetin e Vlorës, dhe tani ai ndodhet duke vuajtur dënimin me burgim në I.E.V.P. Krujë se ai ka nevojë për ndërhyrje kirurgjikale të specializuar që do shërbejë për korigjimin e komplikacioneve dhe shkurtimit të këmbës (gjymtyrës) së majtë.

Duke qënë se ky vendim gjyqësor ka marrë formë të prerë, dhe nga arsyetimi i këtij vendimi del se në rastin konkret i dënuari F. Z. ka nevojë për kujdes dhe trajtim mjeksor të veçantë, mendojmë se kemi të bëjmë në radhë të parë me anën njerëzore, ashtu edhe me një detyrimin kushtetues dhe ligjor të interesimit dhe të marrjes së masave shterore shëndetësore nga ana juaj. Pas ekzaminimeve të plota mjeksore të dënuarit F. Z. i kanë përcaktuar diagnozën përkatëse dhe kanë përcaktuar se tek ai duhet ndërhyrë me operacion për shërimin e tij në të ardhmen.

Në nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet se:"***Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore***".

Po kështu jurispodenca e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm është konsideruar pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor ekzekutimi i tyre në kuptimin e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata, ka pohuar gjithashtu se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës dhe të vet nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Çdo organ shtetror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre.

Në këto kushte dhe duke u bazuar në kërkesave e nenit 6/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se:"***Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike***", dhe nga neni 24/c të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999"Për Avokatin e Popullit", ku parashikohet se:

"***Avokati i Popullit paraqet rekomandim për marrje masash kur vëren shkelje të drejtave dhe lirive tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen e të drejtave dhe lirive***".

Për sa sipër ju

R E K O M A N D O N :

1. Të merren masa për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, datë 10.05.2015 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Krujë për të dënuarin F. Z.

2. Për qëndrimin dhe masat e marra nga ana juaj për zbatimin e këtij rekomandimi, lutemi të vihemi në dijeni brenda 30 ditëve, në bazë të nenit 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999"Për Avokatin e Popullit".

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI